


374/20  
dt. 13/08/2020



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN**

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: " Milaim Bejta B.I."emri i biznesit / " Bushgegu 89 " emri tregtar, me seli në Prishtinë, Autoriteti Kontraktues – Zyrtari Përgjegjës për Prokurim Publik i Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën 13.08.2020, merr :

**V E N D I M**

1. **Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e pasuksesshëm të subjektit në procedurë: " Milaim Bejta B.I."emri i biznesit / " Bushgegu 89 "emri tregtar, me seli në Prishtinë, në procedurën e prokurimit me titull: " Furnizimi me dru për ngrohje " Nr.i prokurimit: VU644 – 20 – 2120 – 1-1-1 e Nr. i brendshëm: 644-20-022-111.
2. **Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 04.08.2020

**A r s y e t i m**

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ( në tekstin e mëtejmë A.K. ) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që ta rekomandoi për dhënie të kontratës Op. Ek.: " AOME "sh.p.k. me seli në Prishtinë ndërsa, O.E.: " Milaim Bejta B.I."emri i biznesit / " Bushgegu 89 " emri tregtar, me seli në Prishtinë ( në tekstin e mëtejmë Ankuesin) ta renditë në mesin e O.E. të pasuksesshëm, bazuar në procedurën e zbatuar.

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e pasuksesshëm për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. 04.08.2020, bazuar në dispozitat e nenit 43 të Rregullores mbi Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se A.K. duke vendosur si në Vendimin e dt. 04.08.2020 ka shkelur dispozitat e LPP-së , konkretisht: nenin 1-Qëllimi, nenin, neni 7-Barazia dhe Trajtimi, nenin 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, nenin 64 – Dëshmitë e kërkeseve, nenin 65 paragrafi 4.8 – Pranueshmëria e kandidatëve /tenderuesve, nenin 72 – dokumentacioni dhe informacioni shtesë si dhe nenin 4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, më tej ( ROUPP ).

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë, për arsy se:

1. Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Neni 33 paragrafi 1 ( Procedurë e Hapur ) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 ( tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët ) ka pasur për qëllim që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimi dhe vlerësimi të tenderëve, bazuar në nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 " Kriteret e Dhënies së Kontratës " të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Mbi këtë bazë

- A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 04.08.2020 është marrë bazuar në kushtet , rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së, vendimi, sikurse ka vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar nga interesat personale, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe genësore të dispozitave të LPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent, duke përfshirë këtu edhe të drejtën Ankuesit për të realizuar qasjen në dokumente të tenderit. Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik: “ **AOME** ” sh.p.k. me seli në Prishtinë ” është marrë në mes tjerash edhe në zbatimin e nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përbushë minimalisht kërkesat e përzgjedhjes të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Konratë.
3. Kërkesat minimale të kualifikimit, të cilat së bashku dhe me Kriteret e përshtatshmërisë karakterizohen edhe si Kritere të Përzgjedhjes, të saktësuara si në Njoftimin për Konratë dhe në Dosjen e Tenderit, sikurse ka vlerësuar A.K., janë proporcionale dhe në harmoni me natyrën dhe kompleksitetin e furnizimeve të cilat janë lëndë e aktivitetit të prokurimit në fjalë, e që është në pajtim dhe me nenin 51 të LPP-së sa i përket Kritereve të përzgjedhjes. Pretendimi i Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës është i papërgjegjshëm sepse nuk përbushë Kërkesën nga FTD – Kërkesat lidhur me mundësitet teknike dhe / ose profesionale neni 9.1 lidhur me 9.2 citat : **“ Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te furnizimeve te njejta, ne vlore minimale prej 160.000,00 Euro, tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për konratë). Në rast Grupi te OE, lideri i Grupit duhet ti ketë 60 % të vlerës së referencave „ mbarim citati, përfaktin se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk përbushë Kërkesat përfunduar përfunduar pëfurnizime të njejta në tre vitet e fundit në vlerë prej 160.000,00€ ngase A.K. ka marrë përbazë edhe refrencat e O.E. që tregojnë furnizim dhe me pelet, dhe në këtë mënyrë kjo paraqet devijim nga Kërkesat e specifikuara në nenin 9.1 lidhur me 9.2 të FTD-së, spas vlerësimit të A.K. ky devijim,në kuptim të dispozitave të nenit 41.6 të RUOPP, nuk duhe trituar si devijim i konsiderueshëm dhe nuk don të thotë trajtim i pabarabartë në mes të O.E.**
4. Ndërsa sa i përket pretendimit të Ankuesit se A.K. ka shkelur nenin 65 paragrafi 4.8 të LPP-së lidhur me nenin 59 të LPP-së lidhur me përbushjen e kërkesave të kualifikimit dhe të përzgjedhjes si dhe të Kriterit për Dhënie të Kontratës, A.K. konstaton padiskutueshëm se dispozitat e nenit 59 janë respektuar në plotni pasi që A.K. ka vendosur dhe rekomanduar përdhënie të kontratës O.E. **“ AOME ” sh.p.k. me seli në Prishtinë pikërisht mbi bazën e kriterit të dhënies së kontratës të përcaktuar në Njoftimin për Konratë dhe në Dosjen e Tenderit, dmth: “ tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët ”.** Pretendim i Ankuesit se i rekomanduanari përdhënie të kontratës < “ **AOME** ” sh.p.k. nuk ka sjellë Vërtetimin e rregullt – valid nga Agjioni Pyjor i Kosovës nga se Vërtetimi nuk përban numrin referues të Dosjes së Tenderit, nuk tregon se përfshirë qëllimi mundë të përdoret Vërtetimi si dhe data e lëshimit të Vërtetimit është më dt. 15.05.2020 që donë të thotë se dokumenti është lëshuar para publikimit të Njoftimit për Konratës, duke ngritisur dyshimin se një dokument i tillë mundë të jetë i parregullt dhe që nuk tregon realitetin, sipas vlerësimit të A.K. nuk është i qëndrueshëm dhe i saktë përfaktin se, fillimisht kërkesa të tillë nuk janë saktësuar dhe / ose specifikuara paraprakisht në Njoftimin për Konratë dhe Dosjen e Tenderit dhe, A.K. nuk do të diskualifikoi ose përfjashtoi nga procedura e prokurimit asnjë tenderues, në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në Njoftimin për Konratës dhe në Dosjen e Tenderit, andaj, A.K., në kuptim të nenit 41.11 të RUOPP dokumentin – Vërtetimin e lëshuar nga Agjioni Pyjor i Kosovës e ka trajtuar si dokument valid, të rregullt. Përf informim të Ankuesit, A.K., bazuar në kërkesën e Ankuesit dhe dyshimeve të ngritisura prej tij lidhur me validitetin e dokumentit në fjalë, ka kërkuar zyrtarisht dhe me shkrim sqarim nga Agjioni Pyjor i Kosovës, nga i cili ka marrë përgjigje po ashtu me shkrim, sipas të cilit çështjet e ngritisura nga Agjioni nuk hyjnë në çështjet që rregullohen në bazë të nenit 65 paragrafi 1, 2 3 dhe 4 të LPP-së.

5. Po ashtu është me interes të sqarohet se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve respektivisht vlerësimi i dëshmive të dorëzuar në dosjen e tenderit dhe marrja e Vendimit mbi bazën e vlerësimit të dëshmive të dorëzuar është marrë në pajtim të plotë me nenin 39.3 dhe 39.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik sa i përket kërkesave lidhur me marrjen e informacioneve dhe / ose dokumenteve shtesë të cilat eventualisht mungojnë në dosjen e tenderit.
6. Në fund A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit për të përgjedhur për rekomandim me dhënie të kontratës të O.E.: "AOME" sh.p.k. me seli në Prishtinë " nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, konkretisht neni 1- Qëllimi, neni 6- Ekonomiciteti dhe efikasiteti sepse është rekomanduar O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çminin më të ulët, neni 7-Barazia dhe Trajtimi sepse me asnje provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo-barabar apo diskriminuese, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 52 parag. 4 – Njoftimi i kritereve për dhënen e kontratës, neni 54 parag. 1 dhe 2 – Njoftimi i kandidatëve dhe tenderuesve të pasuksesshëm, neni 56 parag. 3 – Përgjedhja e pjesëmarrësve dhe dhënia e kontratës, neni 59 parag.4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, neni 60 – Kriteret e Dhënies, neni 69 – Aftësia Teknikë dhe Profesionale dhe neni 72 Dokumentet dhe Informatat shtesë, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K., janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së A.K. vlerëson se nuk ka asnje arsyë të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
K.R. nr. 022/2020 - datë 13/08/2020

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Drejtoria për Prokurim Publik

Hyda Dallku-ZPP

